



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____ 2015

Dt: 28.07.2015

Kryetarja e komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 8,9,10 dhe 16.1 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve komunale dhe përfundimit nr. 06-38833-10/2 i miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtoreve i mbajtur me dt. 10.06.2015, me të cilin është miratuar kërkesa e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për subvencionimin e 10-12 vreshtarëve të Komunës së Gjakovës me gërrshërë pneumatike për krasitje të vreshtave, e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për subvencionimin e sektorit të vreshtarisë në Komunën e Gjakovës duke i mbështetur me mjete financiare në vlerë prej 4,640.00€, për sigurimin dhe shpërndarjen e gërrshërëve pneumatike.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 4,640.00€ nga mjetet e subvencioneve të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me të cilat do të mundësohet realizimi i obligimeve të Komunës së Gjakovës sipas kontratës me operatorin ekonomik NPT "Haxhijaha" me seli në Rahovec me nr. kontrate 066 të datës 08.07.2015 dhe transferimi i vlerës së subvencioneve prej 4,640.00€ do të bëhet në xhirollogarinë e operatorit ekonomik në NLB Bank me nr. 1705001011122970.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
 - Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
 - Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila